



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M


Nr. 03, datë 28.12.2020

**PËR**  
**MIRATIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR,**  
**BASHKIA PEQIN**

Në mbështetje të neneve 7, 20 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar si dhe të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Peqin Nr. 127, datë 16.12.2020 “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Peqin”, me propozimin e Bashkisë Peqin, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Peqin, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:
  - a) Strategjia Territoriale, shoqëruar me përmbledhjen e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit;
  - b) Plani i Zhvillimit të Territorit, shoqëruar me Shtojcën I, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit;
  - c) Rregullorja e Planit;
  - d) Vlerësimi Strategjik Mjedisor;
  - e) Materiali hartografik:
    - i. Vizioni strategjik;
    - ii. Sistemet territoriale të propozuara;
    - iii. Ndarja e territorit në zona dhe njësi;
    - iv. Përdorimi i propozuar i tokës;
    - v. Infrastruktura e transportit;
    - vi. Fazat e zbatimit të PPV-së.
2. Në Zonat e Rëndësisë Kombëtare brenda territorit administrativ të Bashkisë Peqin, shpallur si të tilla nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit apo me vendime të veçanta, autoriteti përgjegjës për miratimin e Planeve të Detajuara është Këshilli Kombëtar i Territorit.
3. Në Zonat e përcaktuara si të Rëndësisë Kombëtare dhe për Objektet e Rëndësisë Kombëtare, përfshirë edhe ato që ngrihen në pronat shtetërore të patransferuara në njësitë e qeverisjes



vendore, autoriteti përgjegjës për miratimin e Lejeve të Zhvillimit dhe Ndërtimit, është Këshilli Kombëtar i Territorit.

4. Gjatë hartimit të Planeve të Detajuara Vendore, projekteve strategjike, projekteve pilot të zhvillimit, si dhe çdo projekti tjetër për zhvillimin e territorit, Bashkia Peqin duhet të bazohet në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Planit i Përgjithshëm Vendor.
5. Ngarkohet Bashkia Peqin për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, si dhe për bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me AKPT-në, Ministrinë përgjegjëse dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore, sipas fushave të përgjegjësisë.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen studimet urbanistike/dokumentat e planifikimit të miratuara më parë nga KRRTRSH/KKT për territorin administrativ të Bashkisë Peqin përfshirë, por pa u kufizuar në to, si më poshtë:
  - Vendim Nr.12, datë 01.09.1993 “Për zgjerimin e vijës kufizuese të qytetit të Peqinit”;
  - Vendim Nr. 27, datë 10.06.1994 “Për studimin urbanistik të planit rregullues të qytetit të Peqinit”;
  - Vendim Nr. 1, datë 13.01.2009 “Detyra e Projektimit të Planit të Përgjithshëm Rregullues të Qytetit të Peqinit”.
7. Planet e detajuara vendore dhe lejet e ndërtimit të miratuara në zbatim të dokumenteve të planifikimit të mëparshme, të cilave nuk u ka mbaruar afati i zbatimit, mbeten në fuqi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDIRA MA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

